



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.10/2017
Prishtinë, më 22.12.2017, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha – Shala, kryetare, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari – Lila, Memli Krasniqi, Gani Dreshaj, Bilall Sherifi, Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Dardan Molliqaj dhe Qëndron Kastrati, anëtarë.

I ftuar: Z. Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik.

Pjesëmarrës të tjerë: Nazmi Zenelaj, Halit Hoxhaj, Lulzim Demolli, Shkumbin Asllani – MZHE; Dardan Abazi – INDEP; Leotrim Latifi – Praktikant dhe Etleva Malushaj GP/LVV.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha - Shala, kryetare e komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 12,13 dhe 15.12.2017;
3. Shqyrtimi i Strategjisë së Energjisë të Republikës së Kosovës 2017-2026;
4. Raportim i ministrit të Zhvillimit Ekonomik z. Valdrin Lluka, lidhur me prioritetet e ministrisë;
5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 12,13 dhe 15.12.2017

Procesverbalet, nga mbledhjet e mbajtura më 12,13 dhe 15.12.2017, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Strategjisë së Energjisë të Republikës së Kosovës 2017-2026

Kryetarja fillimisht uroi ministrin për nënshkrimin e kontratës me “Contour Global” për ndërtimin e Termocentralit “Kosova e Re”. Ajo tha se baza ligjore e Strategjisë së energjisë së Republikës së Kosovës 2017-2026 është e rregulluar me Ligjin nr.05/L-081 për Energjinë. Kjo strategji hartohet për një periudhë dhjetëvjeçare, dhe rishikohet çdo tre vjet duke i marrë parasysh rrethanat zhvillimore në Kosovë. Kjo strategji është dorëzuar në Kuvend, në tetor. Ajo shtoi se sot e kemi të ftuar ministrin e Zhvillimit Ekonomik për të prezantuar Strategjinë në Komision, dhe ia kaloi fjalën ministrit Lluka.

Z. Valdrin Lluka, ministër i Zhvillimit Ekonomik, përshëndeti anëtarët e komisionit, dhe sqaroi se pas një pune të gjatë me këtë strategji e kemi proceduar për miratim në Kuvend. Shtoj se Strategjia është punuar në fillim të këtij viti. Strategjia synon krijimin e një sektori të qëndrueshëm të energjisë. Kjo strategji ka përcaktuar pesë objektiva strategjike: 1. Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe cilësor me energji elektrike dhe me kapacitete të nevojshme për një sistem stabil të energjisë elektrike; 2. Integrimi në Tregun Rajonal të Energjisë; 3. Rritja e kapaciteteve ekzistuese të sistemeve termike dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja; 4. Zhvillimi i infrastrukturës së gazit natyror; 5. Plotësimi i caqeve dhe obligimeve në eficiencë të energjisë, burime të ripërtërishme të energjisë dhe mbrojtje të mjedisit. Orientimi i strategjisë është përcaktuar duke marrë për bazë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, ruajtjen e mjedisit, furnizimin e sigurt dhe cilësor të konsumatorëve, shfrytëzimin eficient të energjisë, zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese konvencionale dhe të ripërtërishme, krijimin e tregut konkurrues, zhvillimin e sektorit të gazit natyror dhe krijimin e vendeve të reja të punës që ndërlidhen me sektorin e energjisë.

Mimoza Kusari-Lila theksoi se për furnizim të qëndrueshëm duhen dy vite për me siguruar linjitin. Ndërtimi i termocentralit Kosova e Re është një hap përpara, mirëpo, në rast se Kosova nuk arrin të nxjerrë linjit atëherë duhet t’i paguhet 100% operatorit të gjenerimit. Cila është strategjia për zbatimin e marrëveshjes për termocentralin Kosova e Re? Ku kanë mbetur projektet për ngrohtoret dhe kogjenerimin? Çka po bëhet për gazin natyror pasi nuk ka asgjë ende? Për BRE Kosova është në pikën më të ulët, por para Ukrainës, si do të rriten burimet e ripërtërishme? Keni menduar që kapacitetet gjenerues solare nga 30 MW me kaluar në 50 MW, si do të reflektohet kjo në tarifat e energjisë elektrike?

Ministri potencoi se sa i përket rezervave të thëngjillit ka dy vite që është ky problem. Tash kemi ardhur në një vendim të zhvendosjes, 100% e familjeve e kanë nënshkruar marrëveshjen për zhvendosje. Për nxjerrjen e thëngjillit nevojiten 4-6 muaj. Me Kosovën e Re marrim obligim për furnizim me lëndë të parë. Ne jemi të obliguar të furnizojmë me thëngjill dhe jemi përcaktuar për furnizim me vlera kalorike. Nëse nuk punon termocentrali se shkak i mos furnizimit me thëngjill ne duhet të paguajmë për komplet kapacitetin. Integrimi me Shqipërinë, problem mbetet anëtarësimi i KOSTT në ENTSO-E, pra anëtarësimi po pengohet nga Serbia. Lidhur me marrëveshjen për hapjen e kompanisë furnizuese në veri, ajo kompani aplikon, por nuk shkruan emërtimet në pajtim me legjislacionin e Kosovës dhe si të tillë nuk e pranon Agjencia për Regjistrim të Bizneseve. Ndërsa mbulimi i humbjeve në veri është problem dhe do të shohim se si do t'i mbulojmë këto humbje. Sa i përket kapaciteteve termike me ndërtimin e termocentralit të ri dyfishohen kapacitetet termike dhe do të zgjerohet rrjeti i ngrohjes. Për Gazin janë duke u bërë termat e referencës për studimin e fizibilitetit për furnizim me gaz dhe qasjen në rrjetet e gazsjellësit. Burimet e ripërtërishme, janë vendosur caqet dhe mendojmë se energjia solare të rritet deri në 80MW. Ne duhet t'i përdorim fitimtarifat për BRE. Në disa vende kanë ra fitimtarifat, ndërsa po synojmë që nga fitimtarifat me kaluar në sistem të ankandit. Ka potencial që çmimi i energjisë solare të ulët.

Mimoza Kusari-Lila pyeti se a keni miratuar plan dinamik të procesit të mihjes që parasheh shpronësimin dhe ndalimin e ndërtimeve pa leje nga Komuna e Obiliqit?

Ministri sqaroi se është duke u bërë studimi i fizibilitetit. Investimi në miniera është i obligueshëm. Për ndërtimet pa leje kemi marrë masa, kemi kërkuar nga Ministria e Mjedisit dhe Komuna e Obiliqit që mos të lejojnë një Shipitullë të Re.

Hykmete Bajrami theksoi se janë dhënë licenca për 200 MW nga BRE, por ende nuk janë arritur. Licencat të monitorohen se a po aktivizohen. Operatorët kanë marrë licenca me tendencën që t'i shesin ato licenca. Me UA të rregullohen që licencat t'i merren operatorëve nëse nuk aktivizojnë prodhimin nga BRE. Çmimet e energjisë nga BRE duhet të ulën. Mos adresimi adekuat i naftës, ne kemi obligim të krijojmë rezerva për 90 ditë shpenzime, kjo ishte synuar me ligjin për naftën, por nuk kishte kaluar në Kuvend. Sa do të jetë çmimi i energjisë elektrike me projektin Kosova e Re, pra sa është sot dhe sa do të jetë pas ndërtimit të termocentralit Kosova e Re? Lidhur me kushtet e marrëveshjes me Contour Global, KEDS nuk ka pranuar me ble energji elektrike nga Contour Global, Kosova duhet me krijuar ndërmarrje publike për me ble energjinë elektrike nga Contour Global dhe me ia shit KEDS-it, A mund të shantazhohet Kosova nga operatori i furnizimit dhe të mos e blejë energjinë elektrike nga ndërmarrja publike duke thënë se ka gjetur ma lirë në treg?

Ministri informoi se afati i licencave për energji solare është katër vite, dhe se duhet të zvogëlohet në një vit. Për licencat vendos ZRRE-ja në bazë të ligjit. Për BRE-në do të jetë një projekt nga IPA për studimin e strategjisë për 30 vitet e ardhshme. Ndërsa çështja e naftës nuk trajtohet me këtë strategji. Çmimi tash është 28 €/MW, ndërsa pas ndërtimit të termocentralit Kosova e re, për shkak të kredive, teknologjive të reja çmimi pritet të jetë 65-70 €/MW. Blerja e energjisë elektrike nga Kosova e re ka garancinë për 20 vite, blerjen do ta bëjë KOSTT-ti dhe nuk do të ketë ndërmarrje tjetër publike. Kontrata me Contour Global do të bëhet publike javën e ardhshme.

Hykmete Bajrami theksoi se për mbulimin e humbjeve nga veriu si një nga burimet për mbulim të këtyre humbjeve duhet parë Fondin për komunat e veriut. Qasja e ZRRE-së ndaj operatorit të shpërndarjes nuk ka ndryshuar pasi KEDS-i u privatizuar. KEDS-i ka mundësi që të punësojë punëtorë nga pjesa veriore dhe të inkasojë mjetet ose të bëjë ndërprerje të energjisë elektrike.

Ministri tha se fondin për veriun e kemi shikuar si mundësi. Ky fond është vetëm për investime kapitale, por do të ishte gjëja më e mirë që nga ky fond të mbulohen energjia e shpenzuar në veri. Është njohur si humbje energjia e shpenzuar në veri sepse nuk kemi arrite me i krijuar qasje në veri KEDS-it.

Memli Krasniqi përgëzoi ministrin për finalizimin e marrëveshjes me Contour Global. Kërkoj sqarim për punën e Komitetit teknik emergjent për zgjidhje të furnizimit, ndërsa fondi zhvillimor për veriun kërkoj të shihet si mundësi për mbulim të humbjeve. Te objektivi 5 edhe BRE edhe Eficienca e energjisë janë vendos bashkë dhe mendoj që duhet të ndahen. Sa është e realizueshme arritja e 25% për BRE deri në fund të vitit 2020? Sa do të mundim me prodhuar energji të ripërtërishme? Sa i përket licencave, te sistemet me hidro ka pasur disa projekte, ndërsa të tjerat janë vonuar dhe duhet të ketë afat të caktuar të licencave me kushte shtesë. A ka me u krijuar ONE STOP SHOP për sektorin e energjisë? A mund të dimë kur do të dekomisionohet termocentrali Kosova A? Termocentrali Kosova e Re kur mundën me prit qytetarët që të hyjnë në funksion?

Kryetarja theksoi se ishim në Komunitetin e Energjisë dhe si konkluzion nga këto takime doli që shtetet të orientohen në resurset e tyre kombëtare të energjisë. Termocentrali Kosova e Re do të jetë me teknologji moderne me pak ndotje dhe me më pak deponi të hirit.

Ministri sqaroi se sa i përket termocentralit të ri edhe ne kërkojmë mbrojtjen e mjedisit. Ky termocentral i ri do të ketë 25 herë më pak emetim të sulfurit, 20 herë më pak emetim të pluhurit, 40% më eficient me teknologji se sa Kosova A dhe 25% më eficient se Kosova B. Ndarja e objektivit 5 nuk është e nevojshme sepse edhe eficienca e energjisë është burim i ripërtërishëm i energjisë. Afatet dhe kushtet duhet të jenë më strikte për licencë. Në vitin 2022 pritët të fillon Kosova e Re, dhe pasi të fillon atëherë do të fillohet me dekomisionimin e Kosovës A. ONE STOP SHOP është problem sepse përgjegjësia është e shtrirë në shumë autoritete. Termocentralin Kosova e Re për 20 vite do të jetë në pronësi të Contour Global, pas 20 viteve i mbetet Kosovës. Nga kyçjet ilegale humbje janë 25%.

Nazmi Zenelaj, sekretar i MZHE-së, theksoi se kemi punuar në drejtim të krijimit të ONE STOP SHOP për sektorin e energjisë, kemi pasur ekspert, kemi shumë autoritete me përgjegjësi ligjore, është rishikuar legjislacioni, dhe po punohet që çështja e licencave të jetë e koncentruar në ZRRE. Pra, çështja e ONE STOP SHOP-eve është sfidë ligjore.

Mimoza Kusari-Lila theksoi se po diskutojmë për mbulimin e humbjeve për pjesën e veriut, e nuk po diskutojmë për zgjidhjen e këtij problemi. Çka është duke bërë Qeveria që të zbatohet marrëveshja, ku është procedura e regjistrimit të kompanisë për furnizim në veri?

Hykmete Bajrami, shtoi se në qoftë se Qeveria vazhdon me paguar rrymën për pjesën veriore atëherë ata nuk do të kenë motivim me paguar rrymën e as me regjistruar kompaninë për furnizim në veri.

Ministri informoi se lidhur me anëtarësimin e KOSTT në ENTSO-E negociatat janë transferuar nga Brukseli në Sekretariat të Komunitetit të Energjisë. Ne kemi bërë propozimet tona, ndërsa Serbia ende nuk i ka bërë. Për këto negociata është caktuar një ndërmjetësues nga Qeveria Gjermane i cili po ndihmon në negociatat për anëtarësim. Problemi lidhur me regjistrimin e kompanisë për furnizim në veri është se në statut i shkruan “Kosova i Metohija”. Shkycja kolektive nuk mundet me ndodh.

Pas diskutimeve, komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026;*
- 2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës 2017-2026;*
- 3. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputetja Sala Berisha - Shala, kryetare e Komisionit.*

4. Raportim i ministrit të Zhvillimit Ekomomik, z. Valdrin Lluka, lidhur me prioritetet e ministrisë

Kryetarja, pas konsultimit me anëtarë tjerë të Komisionit, theksoi se për këtë pikë të rendit të ditës fillimisht do të bëjmë pyetje e mandej të përgjigjet Ministri dhe të prezanton prioritetet e ministrisë. Kryetarja pyeti se deri ku ka shkuar procesi me emërimin e bordit të Trepçës? Po ashtu kërkoi që sektori minerar të trajtohet me prioritet nga ministria, si dhe projektligji për miniera dhe minerale i cili është dërguar për mendim në Qeveri të procedohet pa vonesë.

Mimoza Kusari-Lila kërkoi sqarim për punën e Njesisë për monitorim të ndërmarrjeve publike, duke potencuar se menaxhimi i ndërmarrjeve publike ka shënuar rënie dhe lista e ndërmarrjeve publike që subvencionohen po rritet. Për KRU Radoniqi ekziston kërkesa që të bëhet KRU Gjakova. A jeni të vetëdijshëm për shkeljet sepse nuk është regjistruar ende si KRU Gjakova? A do të ndërmerri hapa në aspektin e keq menaxhimit të kësaj ndërmarrje. Aty po bëhet ndërtim pa leje. Çka po ndodh me aeroportin e Gjakovës?

Hykmete Bajrami pyeti se ku jemi me studimin e fizibilitetit për Trepçën, tërheqjen e kapitalit privat për Trepçën dhe në përgjithësi në Kosovë? Deri kur me i subvencionuar shteti ndërmarrjet publike? Ata po i rrisin pagat, po e rritin numrin e punëtorëve.

Kryetarja, theksoi se bordi për KEK-un është kompletuar, por nuk është respektuar kuota gjinore që sipas ligjit për ndërmarrjet publike kërkohet të jetë 50% gra, andaj ministria të angazhohet që të respektohet ligji lidhur me kuotën gjinore. Të shtohen kapacitetet e Njesisë për monitorim të ndërmarrjeve publike dhe të ushtroni mbikëqyrjen ndaj këtyre ndërmarrjeve në veçanti ndaj KEK-ut.

Ministri sqaroi se konkursi për bordin e Trepçës është mbyllur, dhe është në proces emërimi i bordit. Në mars apo prill pritet të punësohet menaxhimenti. Studimi i fizibilitetit dhe verifikimi i rezervave deri në qershor 2018 do të kryhen. Mendimi për Projektligjin për miniera dhe minerale është proceduar në Qeveri. Zonat e interesit mineral, janë 11 zona të interesit të veçantë, kemi kërkuar informacione se si do të hapen këto dhe pritet që tri prej këtyre zonave të lirohen. Ka probleme me Agjencinë e pyjeve sa i përket licencave për shfrytëzim mineral për shkak se japin afate më të shkurta dhe sipërfaqe më të vogla. Sa i përket ndërmarrjeve publike raportin për performancën e ndërmarrjeve publike e kemi kaluar, ka rritje të shpenzimeve, ka ndërmarrje me humbje, 11 nga 16 ndërmarrje janë me humbje. Ka pasur rritje të punësimit në ndërmarrje publike dhe mund të themi se gjendja nuk është në rregull. Vendimi i parë i yni ka qenë ndalimi i të gjitha bonuseve, si dhe është kërkuar racionalizim i shpenzimeve. Ne kemi kaluar koncept dokumentin për ndryshimin e ligjit për ndërmarrjet publike dhe do të shohim se si do t'i adresojmë këto çështje me ligjin e ri.

Nazmi Zenelaj, MZHE, theksoi se ligji për barazi gjinore kërkon që kuota gjinore të respektohet në nivel të organizatës.

Mimoza Kusari-Lila potencoi se ligji për ndërmarrjet publike i referohet përfaqësimit gjinor në nivel të bordit të ndërmarrjeve publike.

Ministri vazhdoi duke thënë se problemi me subvencionim të NP-ve po vazhdon, ka NP me paga enorme, punësime të shumta. Aeroporti i Gjakovës nuk mund të funksionalizohet për shkak të marrëveshjes me Limak, por kemi diskutuar me Limak që të gjejmë një mënyrë për ta funksionalizuar aeroportin e Gjakovës. Si ndërmarrje publike është vështirë të funksionalizohet. Diskrepanca e pagave të NP-ve është e lartë dhe me nivelimet e pagave në nivel të Kosovës kjo çështje do të marrë zgjidhje. KRU Radoniqi është në procedurë të ndryshojë emrin në KRU Gjakova, dhe është aprovuar në Qeveri.

Nazmi Zenelaj theksoi se ndërtimi në KRU Radoniqi përbëhet prej tre lotëve, dy prej të cilave janë ndërtuar prej Qeverisë, ndërsa ai objekt ka qenë ekzistues.

Mimoza Kusari-Lila tha se objekti është pa leje sepse iu është tërhequr leja. Ndërtimi brenda u bë për objekt hotelier. Çfarë shkrese keni marrë nga MMPH për këtë rast?

Nazmi Zenelaj sqaroi se neve na kanë thënë se është objekt ekzistues brenda kompleksit të liqenit. Ndërmarrja e ka arsyetuar se ndërtimi është për nevoja të ndërmarrjes, për nevoja të zyrave.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

Ministri i Zhvillimit Ekonomik të raportojë dhe të informojë në vazhdimësi për të gjitha aktivitetet e MZHE-së, komisionin. Ndërsa, komisioni shprehu gatishmërinë për bashkëpunim dhe përkrahje në miratimin e ligjeve që mbulon kjo ministri.

5. Të ndryshme

Çështjet vijuese

Kryetarja informoi anëtarët e komisionit se Qeveria e ka miratuar propozimet për anëtarë të bordit të ZRRE-së dhe këto propozime do t'i shqyrtojmë në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit

Kryetarja e komisionit,

Sala Berisha – Shala